

**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"QSC" SH.P.K.**

Sot më datë 15.10.2021 (dymijë e njëzet e një) themeluesi, ortak i vetëm,

Endri Xhaferasi, i biri i Bashkim dhe Vezire lindur më 25.10.1984, në Korçë, Shqipëri, banues në Tiranë në adresën: Rruga "Riza Çuka", Laprakë pronë private, mbajtës i pasaportës nr. BA1647818, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar;

vendosi krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "QSC" sh.p.k.

**NENI 1
EMËRTIMI**

Emërtimi i kësaj shoqërie me përgjegjësi të kufizuar është QSC, këtu e në vijim e përmendur si "Shoqëria".

**NENI 2
PERSONALITETI JURIDIK DHE FORMA**

Shoqëria fiton personalitet juridik në datën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri. Ndryshimet në përputhje me ligjin dhe statutin, nuk sjellin si pasojë krijimin e një personi juridik të ri.

Shoqëria është person juridik që është e organizuar dhe vepron në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe do të figurojë e prezantohet me emërtimin "QSC sh.p.k".

**NENI 3
SELIA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi i ri Yzberisht, pallati LNK, Hyrja 2, Nr.3, Tiranë, Shqipëri.

Selia e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të ortakut të vetëm.

Shoqëria mund të hapë edhe zyra përfaqësie, degë, filiale, dhe/ose realizojë çdo lloj pjesëmarrjeje në shoqëri të tjera, duke blerë aksione apo kuota kapitali, në mënyrën e parashikuar nga ligji, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 4
OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e çdo aktiviteti të lejuar nga ligji, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij, dhe/ose pjesëmarrjen në çdo aktivitet apo veprimtari të ligjshme që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar sipas legjislacionit shqiptar dhe në veçanti:



- Tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve të aksesorëve si dhe të lëndëve të para për prodhimin e mobiljeve, dyer dritare, artikuj duralumini, të bojrave, veglave të punës si dhe import eksportin e tyre.
- Tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm si elektroshtepiake, hidrosanitare dhe aksesorë të tyre, pajisjeve hidraulike etj
- Tregëtim pajisje zyre, kancelari, pajisje ventilimi dhe kondicionimi
- Transport mallrash kombëtar dhe ndërkombëtar
- Të bëjë çdo aktivitet që në opinionin e ortakut të vetëm ose të ortakëve të tjerë që mund të ketë shoqëria në të ardhmen është e aftë ta bëjë në mënyrë të përshtatshme në lidhje me ndonjë veprimtari të nisur ose pa lidhje me të por që llogaritet që në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë ta rrisë vlerën e biznesit të Shoqërisë, pronës së Shoqërisë ose të ndihmojë ndonjë prej objektivave të saj.
- Të bashkohet me çdo person fizik apo juridik me qëllim realizimin e aktivitetit të saj.
- Të blejë, japë ose marrë me qira, shkëmbejë ndonjë pronë ose interes, private apo shtetërore, të drejta apo privilegje për të cilat Shoqëria mendon se janë të nevojshme ose të favorshme për aktivitetin e saj.
- Të blejë apo të shesë aksione apo kuota kapitali brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Të japë informacione për shoqëritë e huaja të cilat duan të themelojnë e kryejnë biznes në Shqipëri.
- Të merret me organizim eventesh të natyrave të ndryshme si kulturore, artistike, sportive etj;
- Të hyjë në marrëveshje me autoritetet publike, qendrore apo lokale dhe të përdorë të gjitha mundësitë, të drejtat, koncensionet që lidhen me aktivitetet e Shoqërisë ose ndonjë prej tyre;
- Import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë të mallrave, materialeve, aparaturave të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë.

Për kryerjen e aktiviteteve për të cilat nevojitet leje apo formë leje (p.sh.licensë), shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me leje të lëshuar nga institucioni shtetëror kompetent.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është në likuiditet në shumën 100000 (njqind mijë) lekë i ndarë në 1 kuota me vlerë nominale 100000 (njqind mijë) lekë.

I gjithë kapitali zotërohet nga Ortaku i vetëm Endri Xhaferasi.
I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar nga ortakut i vetëm dhe do të depozitohet, në emër të Shoqërisë, në një nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në Tiranë.
Përgjegjësia e ortakut të vetëm, për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e kapitalit të Shoqërisë.

Kapitali themeltar i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet, në varësi të nevojave të saj, me vendim të ortakut të vetëm.



NENI 6
TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme.

Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme edhe në rrugë trashëgimie sipas kushteve të përcaktuara në ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tjerë, qofshin këta fizikë ose juridikë, me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 7
KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin që ka në objekt, për një periudhë kohore të pacaktuar.

Shoqëria mund të mbarojë sipas kushteve të përcaktuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 8
ORTAKU I VETËM DHE KOMPETENCAT E TIJ

Ortaku i vetëm ushtron të gjithë kompetencat që i njihen sipas ligjit, për shkak të kësaj cilësie.

Ortaku i vetëm, mund t'i delegojë kompetencat e tij.

Vendimet e marra prej tij evidencohen në një regjistër të veçantë që depozitohet në selinë e Shoqërisë.

Për sa kohë Shoqëria do të ketë një ortak, ortakut të vetëm, në përputhje me rregullimet ligjore të legjislacionit dhe Statutit të Shoqërisë, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për:

- ndryshimin e këtij Statuti,
- emërimin e një administratori tjetër,
- pjesëmarrjen në shoqëri të tjera,
- zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë,
- transferimin pjesërisht ose tërësisht të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë,
- emërimin e ekspertit (ekspertëve) kontabël të autorizuar,
- miratimin e bilancit të Shoqërisë dhe të çdo raporti financiar,
- shpërndarjen e Shoqërisë,
- likuidimin e Shoqërisë,
- emërimin e likuidatorit (likuidatorëve).

NENI 9
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

1. Emërimi dhe kohëzgjatja e mandatit
Administrator i Shoqërisë është Z. Endri Xhaferasi.



Ai do të qëndrojë në këtë detyrë deri sa të emërohet zëvendësuesi (zëvendësuesja) e tij në rastin që Ortaku i Vetëm do të vendosë të emërojë një person tjetër në këtë detyrë.

2. Kompetencat dhe përgjegjësitë

Administratori përfaqëson Shoqërinë tek të tretët dhe kryen të gjitha veprimet e administrimit në interes të Shoqërisë. Në marrëdhënie me të tretët Administratori e angazhon Shoqërinë nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

NENI 10 EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR

Eksperti (ekspertët) kontabël të autorizuar do të emërohen me vendim të ortakut të vetëm, në çdo rast kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni shqiptar dhe në përputhje me rregullimet dhe kufizimet për papajtueshmëritë.

Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rastet që vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

NENI 11 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor të çdo viti.

Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Kombëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe mbaron më 31 Dhjetor 2021.


NENI 12 LLOGARITË VJETORE

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga Administratori apo Eksperti Kontabël i Autorizuar, marrin miratim nga ortaku i vetëm, brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar të Shoqërisë.

NENI 13 FITIMI QË SHPËRNDARHET

Fitimi, përbëhet dhe llogaritet duke u bazuar në fitimin e realizuar në vitin financiar, dhe do të shpërndahet vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- aktivet e Shoqërisë mbulojnë detyrimet e saj
- Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.



NENI 14
PRISHJA

Prishja e Shoqërisë mund të bëhet për çfarëdolloj arsyeje që e vështirëson apo bën të pamundur vazhdimin e aktivitetit të saj dhe për arsye të tjera të parashikuara në ligj.

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes dhe në këtë kohë emërtimi i Shoqërisë pasohet nga shënimi "Shoqëri në likuidim e sipër". Ky shënim dhe emri i likuiduesit shoqërojnë çdo akt e dokument të nxjerrë nga Shoqëria në adresë të të tretëve.

NENI 15
LIGJI I ZBATUESHËM

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen rregullimet e Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

NENI 16
NDRYSHIMET

Ky Statut mund të ndryshohet dhe/ose shfuqizohet në tërësi dhe të zëvendësohet me një statut të ri me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 17
INTERPRETIMI

Nëse ndonjë rregullim i këtij Statuti, pas fillimit të zbatimit të tij, do të bëhet objekt diskutimi, ai rregullim duhet të interpretohet duke u bazuar në frymën e përgjithshme të Statutit.

ORTAKU I VETËM
ENDRI XHAFERASI



Nënshkruhet sot më datë 15/10/2021